



## AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE "EXTRA LARGE" shpk

Sot më datën .04.2000,

1. z. Dritan HOXHA, i biri i Fiqirit, lindur më 1968, banues në Tiranë, me adresë Rruga "Pandi Dardha", Pall.60, Ap.28, identifikuar me pasaportën Nr. 0161795.
2. z. Hektor PUSTINA, i biri i Nazimit, i datëlindjes 07.03.1959, lindur e banues në Tiranë, me adresë Rruga "Hoxha Tasim", Pall.98, Ap.1, mbajtës i pasaportës Nr. 0705070.
3. z.Fatos BAXHAKU,i biri i Shabanit,i datelindjes 09.01.1964,lindur e banues ne Tirane, me adrese Bulevardi "Bajram Curri", Pall. e Aviacionit te Vjeter Shk.3/25,mbajtes i pasaportes Nr. 0005840.

Te lartepemendurit,me vullnetin e tyre të lirë dhe në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 "Për rregjistrin tregtar" dhe Ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private dhe privatizimit" kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sipas kushteve e normave të parashikuara në Statutin e shoqërisë bashkëngjitur dhe në këtë Akt - Themelimi si më poshtë vijon:

### Neni 1

Ortakët themelojnë Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar:  
**"EXTRA LARGE" shpk**

### Neni 2

Kjo Shoqëri Tregtare do të ketë selinë e saj në Tiranë, në Bulevardin Deshmoret e Kombit Qendra Ndrkombetare e Kultures.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

### Neni 3

**Kohëzgjatja e veprimtarisë** së Shoqërisë do të jetë njezet (20) vjet.

Shoqëria mund të shpërmdahet edhe para këtij afati në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

### Neni 4

**Objekti i veprimtarisë** së Shoqërisë Tregtare "EXTRA LARGE" shpk do të jetë:

- **Aktivitet i gjithanshem botues,ne fushen e shtypit te shkruar,editim revistash,**

gazetash, fletpalosjesh, librash, broshurash, gazetash.

- Aktivitetet ne fushen e reklamave dhe te marketingut, postera, etiketa, materiale shkollore, kopertina te ndryshme, botim fotografish etj.

#### Neni 5

**Kapitali themeltar** i Shoqërisë është 100 000 lekë.

Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 1,000 lekë secila, të renditura nga numri 1 deri në 100 krejtësisht të shlyeshme. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- 1- **z.Dritan HOXHA**, zotëron pesedhjetë e nje (51) pjesë, të renditura nga numri 1 (nje) deri tek numri 51 (pesedhjetë e nje) , që përfaqësojnë 51% të kapitalit.
- 2- **z.Hektor PUSTINA**, zotëron njezet e kater (24) pjesë, te renditura nga numri 52 (pesedhjetë e dy) deri tek numri 76 (shtatedhjetë e gjashtë), që përfaqësojnë 25% të kapitalit.
- 3- **z.Fatos BAXHAKU**, zotëron njezet e kater (24) pjesë, te renditura nga numri 77 (shtatedhjetë e shtate) deri tek numri 100 (njeqint), që përfaqësojnë 24% të kapitalit.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakëve.

#### Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë, përfaqëson kapitalin e derdhur nga Ortakët i nevojshëm për veprimtarinë e Shoqërisë. Sipas kërkesës së ligjit, administratori **Hektor PUSTINA** ka të drejtë të çeli një llogari bankare në **nje nga Bankat shtetërore ose private** në të cilën do të depozitohet kapitali themeltar i shoqërisë në formim.

Kapitali Themeltar mund të përbëhet edhe nga kontribute në natyrë. Në këtë rast vlerësimi i kontributeve në natyrë do të bëhet sipas N. 42 të Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992.

Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë tregtare do të shënohet edhe kapitali i derdhur nga Ortakët.

Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

#### Neni 7

Shoqëria Tregtare në marrëdhëniet me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e shoqërisë, fondet e saja dhe Ortakët përgjigjen për detyrimet e kësaj Shoqërie vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

#### Neni 8

Shoqëria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë ose për shkaqe të tjera të përcaktuara në Statut.

Fitimi neto ndahet sipas pjesëve të kontributit në kapitalin themeltar.



2  
Baxhaku



### Neni 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratorët.

Administratorët emërohen e shkarkohen prej Asamblesë së Ortakëve.

**Administratori i shoqërisë** deri në shkarkimin e tij nga Asambleja e Ortakëve do të jetë **z. Hektor PUSTINA**.

Modalitetet për përbërjen dhe funksionimin e organeve të mësipërme përcaktohen nga statuti i Shoqërisë si dhe nga Ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

### Neni 10

Ortakët janë të detyruar të ruajnë sekretin e dokumentacionit, informacionit, njohjeve dhe të eksperiencës së këmbëz e të realizuar brenda Shoqërisë dhe të marrin të gjitha masat për të evituar përhapjen e tyre qoftë dhe në mënyrë të pjesëshme.

Ortakët janë përgjegjës për pasojat e dëmshme, të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqëritë Tregtare.

### Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të bëhet konform normave të konventave ndërkombëtare për rregullimin e mosmarrëveshjeve në Shoqëritë Tregtare, në Gjykatën e Rrethit Tiranë.


### Neni 12

Më të detajuara dispozitat për Shoqërinë Tregtare "**EXTRA LARGE**"shpk janë përcaktuar dhe përmbahen në Statutin e saj.

### Neni 13

Kjo kontratë formulohet në katër kopje, nga të cilat njëra depozitohet në Zyrën e Noterisë Tiranë, njëra depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në Zyrën e Tatimeve Tiranë dhe kopja e katërt mbahet në dokumentat e Shoqërisë.

Kontrata është e vlefshme që nga momenti i nënshkrimit të saj nga ortakët.

1. Dritay Hoxhu  


ORTAKËT

2. Hektor Pustina  


3. Faton Baxhaku  
Baxhaku

//



**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“EXTRA LARGE” SH.P.K.**

Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar “EXTRA LARGE” Sh.P.K, është krijuar sipas kontratës për themelimin e saj nga **ortakët**:

1. **z. Dritan HOXHA**
2. **z. Hektor PUSTINA**
3. **z.Fatos BAXHAKU**

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj Shoqërie në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin tregtar”, është përpiluar ky Statut sipas kërkesave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar si më poshtë:

**KREU I PARË**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**(forma, emërtimi, objekti, selia, kohëzgjatja)**

*Neni 1*

Ortakët e lartpërmendur pjesëmarrës në Kontratën e Themelimit kanë krijuar një Shoqëri Tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria Tregtare e fiton zotësinë për të vepruar si person juridik me rregjistrimin e saj në **Gjykatën e Rrethit Tiranë** si dhe rregjistrimin e saj në **Rregjistrin Tregtar**.

*Neni 2*

Shoqëria Tregtare emërtohet “EXTRA LARGE” Sh.P.K dhe ka si objekt të saj:

- **Aktivitet i gjithanshem botues,ne fushen e shtyprit te shkruar,editim revistash, gazetash, fletpalosjesh, librash, broshurash, gazetash.**
- **Aktivitet ne fushen e reklamave dhe te marketingut, postera, etiketa, materiale shkollore, kopertina te ndryshme, botim fotografish etj.**



Për përmbushjen e këtij objekti shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose të përafërt.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

- **Selia e shoqërisë tregtare** ndodhet në Tiranë në adresën Bulevardi “Deshmoret e Kombit” Qendra Nderkombetare e Kultures - Tiranë, Shqipëri.
- **Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare** është parashikuar për një periudhë njezet(20) vjeçare.

Ky afat mund të zgjatet ose të zvogëlohet sipas propozimeve të bëra nga ortakët dhe pasi të vendoset nga Asambleja e Ortakëve.

## KREU II

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

#### *Neni 3*

**Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare** është 100 000 lekë. Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 1,000 lekë secila, të renditura nga numri 1 deri në 100 krejtësisht të shlyeshme. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- 1- **z.Dritan HOXHA**, zotëron pesedhjetë e nje (51) pjesë, të renditura nga numri 1 (nje) deri tek numri 51 (pesedhjetë e nje) , që përfaqësojnë 51% të kapitalit.
- 2- **z.Hektor PUSTINA**, zotëron njezet e kater (24) pjesë, te renditura nga numri 52 (pesedhjetë e dy) deri tek numri 76 (shtatedhjetë e gjashtë), që përfaqësojnë 25% të kapitalit.
- 3- **z.Fatos BAXHAKU**, zotëron njezet e kater (24) pjesë, te renditura nganumri 77 (shtatedhjetë e shtate) deri tek numri 100 (njeqint), që përfaqësojnë 24% të kapitalit.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakëve.

Pjesët e Kapitalit Themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por asnjëherë kontribute në shërbime.

Kur pjesët e kapitalit përfaqësojnë kontribute në natyrë vlerësimi i tyre bëhet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkangjitet statutit. Eksperti



caktohet me unanimitet nga ortakët.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

#### *Neni 4*

### **ZMADHIMI I KAPITALIT**

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para, bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 40 të L.Nr.7638/19.11.1992.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të nenit 42, paragrafi i parë i L.Nr.7638/19.11.1992. Megjithatë eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim të gjykatës sipas kërkesës së administratorit.

#### *Neni 5*

### **ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Ekspertët i bëjnë të ditur asamblesë vlerësimin e tyre për arësyet dhe kushtet e zvogëlimit.

#### *Neni 6*

### **TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT**

- Pjesët e kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet parardhësve e pasardhësve.
- Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së Ortakëve që përfaqësojnë të



shtimin dhe pakësimin e kapitalit themeltar, për emërimin e shkarkime të administratorit, për emërimin e ekspertëve kontabël, për pushimin, për hapjen e degëve, përfaqësive dhe filialeve në rrethet e tjera, për transferimin e shoqërisë në një formë tjetër, për zgjatjen e afatit etj.

Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhjet e asamblesë mund të jenë të zakonshme ose të jashtëzakonshme:

- **Asambleja e zakonshme** me shumicë votash, vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimit etj.

Mbledhja është e vlefshme në rast se në të janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, ortakët thirren ose sipas rasti konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna, pavarësisht nga përqindja e kapitalit që përfaqësojnë.

- **Asambleja e jashtëzakonshme** vendos për çështje të tilla si ndryshimi i statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së Shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri të formave të tjera.

Këto vendosen nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit themeltar.

#### **Neni 10**

Vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve në mbledhjet e zakonshme e të jashtëzakonshme, në përputhje me këtë Statut, janë të detyrueshme e të zbatueshme për secilin Ortak.

Asambleja e Ortakëve mbledhjet e zakonshme i bën çdo vit brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarive financiare të Shoqërisë.

#### **Neni 11**

Administratorët emërohen e shkarkohen nga Asambleja e Ortakëve me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve në kapitalin themeltar.

Administratorët mund të zgjidhen edhe jashtë bashkësisë së ortakëve.



### *Neni 12*

Shoqëria administrohet nga **z.Hektor PUSTINA**, i cili zgjidhet për një afat tre(3) vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

### *Neni 13*

Administratori ka këto kompetenca:

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë.

Administratori ka të drejtë që kompetencat t'ia delegojë personave të tretë me Prokurë të Posaçme ku do të përcaktohen shprehimisht të drejtat e deleguara.

### *Neni 14*

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e administratorit duhet të respektohen nga të tretët.

### *Neni 15*

Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfardollosj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Kjo masë është e vlefshme edhe për përfaqësuesit ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë, si dhe bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

### *Neni 16*

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

*Baxhaleu*





### *Neni 17*

Administratori shkarkohet me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar si dhe nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesën e çdonjërit prej ortakëve.

### *Neni 18*

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e administratorëve duhet të respektohen nga të tretët.

### *Neni 19*

Administratorëve ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfardollos formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Kjo masë është e vlefshme edhe për përfaqësuesit ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë, si dhe bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

### *Neni 20*


Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### *Neni 21*

Administratorët shkarkohen nga vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar si dhe nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesën e çdonjërit prej ortakëve.

### *Neni 22*

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore, teksti ivendimeve



të propozuara, si dhe nëqoftëse është nevoja, raporti i ekspertëve kontabël të autorizuar, u komunikohen ortakëve dhe vihen në dispozicion të tyre në selinë e shoqërisë të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.

Ortakët kanë të drejtë të marrin në çdo moment dokumentat e sipër përmendura për 3 vitet e fundit financiarë. Ata mund të ndihmohen nga një ekspert i zgjedhur prej tyre, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

### *Neni 23*

Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për çdo vit financiar me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve me shumicë votash.

### *Neni 24*

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin për një afat jo më shumë se një periudhë 1 vjeçare.

Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të Qeverisë.


## **KREU I TRETË**

### **MARRËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE**

### *Neni 25*

Viti financiar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti, përveç vitit të parë që fillon më muajin Prill 2000.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.



### *Neni 26*

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit, **Asambleja e Ortakëve** përcakton pjesën që i takon mbi fitimin, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për fondin rezervë të domosdoshëm (jo më pak se 1/20 e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar) si dhe të jenë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

### *Neni 27*

Llogaritë ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe, në lekë ose në valutë të huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilancet e përpiluara nga ekspertët kontabël të autorizuar të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për punën e tyre.

### *Neni 28*

Shoqëria Tregtare me qëllim që ta bëjë sa më të lehtë dhe më të shpejtë pagesat me të tretët do të hapë llogari bankare në Bankat që janë të njohura nga Shteti Shqiptar vendase ose të huaja.


## **KAPITULLI I KATËRT** **ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI**

### *Neni 29*

Me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratën e themelimit zgjatja e tij bëhet vetëm me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Ajo prishet kur mbaron afati i përcaktuar dhe Ortakët nuk kanë rënë dakort që të bëjnë ripërtëritjen e këtij afati.

Shoqëria mund të shndërohet në një nga format e përcaktuara nga ligji dhe në formën e kërkuar nga ligji.





*Neni 30*

Shoqëria Tregtare hyn në procesin e likujdimit që në momentin e vendosjes për prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi Asambleja e Ortakëve emëron një likujdues i cili paraqet raportin e likujdimit, gjendjen e aktivitetit të Shoqërisë, mbi mënyrën e ndjekjes së operacionit të likujdimit dhe afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, Asambleja e Ortakëve, vendos mbi bilancin përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likujdimit, mbi mbylljen e procesit të likujdimit të Shoqërisë.


*Neni 31*


Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin ndërmjet Ortakëve ose në marrëdhëniet me të tretët, gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit, gjatë ekzistencës së Shoqërisë si gjatë kryerjes së veprimtarisë ashtu dhe në procesin e likujdimit do të drejtohen për gjykim Gjykatës së Rrethit Tiranë.

*Neni 32*

Ky statut është hartuar në katër kopje, njëra kopje depozitohet në Zyrën e Notarisë, njëra në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet në dokumentat e krijimit të Shoqërisë.

**ORTAKËT**

1. Dorian Hoxha  


2. Hektor Justin e  


3. Faton Baxhaku  
